ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **K.R.U. MITROVICA SH.A.**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **KURM-25-262-1-2-1**

Sa i përket tenderit për **Furnizim me Eskavator**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	**Segment Kosova SH.P.K.**
NUI	**810871328**
Adresa	**Lagja Marigona, Preoc, Gracanice**
Vendi	**Gracanice**
Kodi postar	**10500**
Numri Telefonit	**038/733794**
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	**Ilir Zhabari**
Adresa elektronike	**procurement@segment-rks.com**
Data e parashtrimit të ankesës	**24.03.2025**

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit

Adresa e plotë

Numri i Telefonit

Numri i faks-it

Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

Furnizim me Eskavator

22.01.2025 – Publikohet Dosja e Tenderit, ndërsa me datë 03.02.2025 bëhet korrigjimi i dosjes.

03.03.2025 – AK nxjerrë Njoftimin mbi Vendimin e AK-së me të cilin shpërblen me kontratë Grup i Operatorëve Ekonomik BauMachine L.L.C.; Enver Baliu B.I në vlerë totale të ofertës: 93,550.00 Euro. Kjo perkunder faktit se i rekomanduari per Kontrate eshte qartesisht i papergjegjshem.

OE Segment Kosova pranon Letrën standarde për tenderuesin e pasukssesshëm, duke konfirmuar se Segment Kosova ka ofertw tw pwrgjegjshme.

10.03.2025 – GOE Segment Kosova paraqet këtë Kërkesë për Rishqyrtim.

13.03.2025 - GOE Segment Kosova pranon Vendimin e AK-së, i cili refuzon si të pabazuar kërkesën për rishqyrtim të OE Segment lidhur me aktivitetin e prokurimit në fjalë.

24.03.2025 - GOE Segment Kosova paraqet këtë Ankesë pranë OSHP.

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐ ***Jo*** ☒

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒ **Jo** ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontestit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se.

Kerkesa jone per rishqyrtim eshte refuzuar, po e bashkangjesim vendimin e AK lidhur me Kerkesen per Rishqyrtim.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Ligji nr. 04/L-042, për Prokurim Publik, i konsoliduar (LPP)

Neni 7, Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminim:

1. Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jodiskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.
2. Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë te një se më shume operatoreve ekonomik

Neni 72, dokumentacioni dhe informacioni shtesë

1. Kur informacioni apo dokumentacioni që duhet të dorëzohet nga operatorët ekonomikë është ose duket të jetë jo i plotë ose i gabuar, ose kur mungojnë dokumentet specifike, autoritetet kontraktuese mund të kërkojnë nga operatorët ekonomikë qe të dorëzojnë, plotësojnë, sqarojnë apo kompletojnë informacionin apo dokumentacionin e duhur brenda një afati te caktuar kohor, me kusht që kërkesat e tilla bëhen në përputhje të plotë me parimet e trajtimit të barabartë dhe transparencës

Neni 59, paragragi 4 mbi ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve:

Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit."

Rregullore Nr.001/2022 për Prokurimin Publik (Rregullore për Prokurim)

Neni 7, Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminim:Gjatë procedurës për ekzaminimin,

vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve asnjë komunikim dhe negocim nuk duhet të ndodhë në mes të autoritetit kontraktues dhe tenderuesve, përveç komunikimeve që janë autorizuar saktësisht nga nenet 34 dhe 35 të LPP. Megjithatë, vetëm sqarim i tenderëve mund të ndodhë pa ndonjë ndryshim të kushteve materiale ose aspekte të tenderit, përveç atyre të lejuara me nenin 59 dhe 72 të LPP-se."

Udhëzues Nr.001/2023 Për Prokurimin Publik (Udhëzues për Prokurim)

Pika 10.1 - Mungon Katalogu - Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Sipas Vendimit te Autoritetit Kontraktues, letres standarde për tenderuesi e pasuksesshëm, tenderi i Grupit te Operatorëve Ekonomik "Segment Kosova SH.P.K.; Segment Sh.A" nuk qe i sukseshem per arsye se nuk ka qene tenderi me cmim me te ulet dhe se per kontrate eshte rekomanduar Grup i Operatorëve Ekonomik BauMachine L.L.C. & Enver Baliu B.I. (D.P.Z.HIDRO-ATLAS Dega ne Kosove)" Pas qasjes ne dokumentacion dhe kemi analizuar oferten e dorezuar nga Grupi i OE te rekomanduar per kontrate kemi konkluuare qe Grupi i OE te rekomanduar per kontrate jane te papergjegjshem, andaj duke u bazuar ne Ligji nr. 04/L-042, për Prokurim Publik dhe RrUOPP kemi dorezuar Kerkese per Rishqyrtim, ku kerkesa jone eshte refuzuar, andaj dergojme kete Ankese.

1. **<u>1. Pretendimi ankimor nr. 1: GOE i rekomanduar për Kontratë nuk ka dorëzuar ofertë të përgjegjshme</u>**

Pika 1.1. Nuk është plotësuar kërkesa për deklaratën për specifikacionet teknike:

Në FTD, në kuadër të specifikacioneve teknike të detyrueshme 3.1, është kërkuar që "Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentet dëshmuese për qëllimin e ofruar të kontratës, duke përfshirë: **a. Deklaratën për specifikacionet teknike për mallrat e ofruara të cilat përputhen me ato të përmendura në Aneksin 1 të dosjes së tenderit"**. (bashkangjitur me poshte pjese nga kerkesa nga Dosja e Tenderit)
Për këtë kërkesë, GOE fitues nuk ka dorëzuar Deklaratë mbi specifikacione teknike. Në fakt, deklarata është lëshuar vetëm nga prodhuesi e jo edhe nga GOE.
Përderisa oferta teknike përmban nënshkrimin e prodhuesit, e njejta nuk përmban edhe nënshkrimin e anëtarëve të GOE fitues, me ç'rast GOE është dashur të eliminohej.

Në këtë kontekst, Udhëzuesi i Prokurimit, në pikën 10.1 përcakton se kur **"Mungon specifikacioni teknik për mallrat e ofruara dhe katalogu", tenderi refuzohet pa kërkuar informacion të mëtejshëm.**

Pika 1.2. Nuk është plotësuar kërkesa për dokumentet për pronësinë e servisimit:

GOE "Segment Kosova SH.P.K.; Segment Sh.A" ka argumentuar se GOE fitues nuk ka dorëzuar dokumenet për pronësinë e objektit ku kryhet servisismi **(nuk ka dorezuar LETREN POSEDUESE siq eshte kerkuar ne FTD).**
Tek Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale **9.1 & 9.2, Kërkesa nr. 3 kërkon që "Operatori ekonomik me oferten e tij, duhet të vertetoje se posedon ne pronesi te vet, OSE e ka te kontraktuar me qira, servisin per servisimin e Eskavatorit**, qe eshte objekt i kësaj kontrate, gjate tere kohes se kerkuar te garancionit 3 vjeçar." **Evidenca** për këtë kërkesa ka qenë "**Kopje e dokumentacionit te pronësisë (letra poseduese)** dhe një deklaratë me shkrim nga OE permes se ciles deklaron se disponon me objektin punëtorine për servisim" OSE kontrata e marrjes me qira bashke me dokumentet e pronesise te qiradhenesit (fleta poseduese e objektit) dhe deklarata po ashtu me shkrim se OE qe e ka servisin nen qira".
GOE fitues në lidhje me këtë kërkesë ka dorëzuar një "Kontratë për autorizim të servisit për eskavator". Kjo kontratë është e lidhur në mes të anëtarëve të konsorciumit, mirëpo, **kjo nuk është kontratë e qirasë siç kërkohet me kërkesën nr. 3, si dhe me të nuk është paraqitur asnjë dokument plotësues mbi pronësisë e qiradhënësit (letrën poseduese) të servisimit të eskavatorit, pra nuk ka dokumentet e pronesise se objektit (nuk ka dorezuar LETREN POSEDUESE siq eshte kerkuar ne FTD).**

Së pari, AK në Vendim për kërkesë për rishqyrtim përgjigjet në këtë pretendim ankimor duke cituar nenin 3 të Kontratës për servisim i cili lexon se: "DPZ HIDRO-ATLAS" Dega në Kosovë me seli në Mitrovicë pajtohet që mjeti të cilin oferton me tender nga Baumachine LLC kan të drejtën për servisim, mirmbajtje në kompanin tonë për periudhën të cilën është e cekur në tender".

Mirëpo, ky nen nuk provon asgjë tjetër përpos se mjeti i ofertuar mund të servisohet tek DPZ Hidro-Atlas.

Së dyti, AK pretendon se DPZ Hidro-Atlas ka dorëzuar të gjitha dëshmitë dokumentare të biznesit të tij, në të cilat dëshmohet qartë se e posedon objektin në të cilën do të kryej servisimin e eksavatorit, si dhe në informata të biznesit si aktivitet primar ka mirëmbajtjen dhe servisimin e automjeteve.

Mirëpo, në qoftë se dokumente të tilla ekzistojnë, atëherë rrjedhë pyetja se përse e njejta nuk figuron në ofertën e dorëzuar nga GOE fitues. Po ashtu, duke qenë se GOE Segment Kosova ka argumentuar se fleta poseduese e cila kërkohet me kërkesën teknike nuk është bashkëngjitur me ofertë (nëse një e tillë ekziston), AK është dashur që në Vendimin për kërkesën për rishqyrtim të bashkëngjes këtë dëshmi që pretendon se GOE fitues e

posedon, ashtu që të dëshmohet se GOE fitues vërtetë e përmbush këtë kërkesë.

Për më tepër, AK pretendon se GOE fitues ka dorëzuar të gjitha dëshmitë se ai e "posedon" objektin ku bën servisimin. Kërkesat e dosjes së tenderit në këtë drejtim janë të qarta: duhet të dorëzohet fleta poseduese që dëshmon së objekti i ky kryhet servisimi është "nën pronësinë" e OE që oferton ose të qiradhënësit kur ekziston një kontratë e qirasë. Prandaj, më tutje vërtetohet fakti se GOE fitues nuk ka në pronësi objektin ky kryhet servisimi.

Po ashtu, fakti se DPZ Hidro-Atlas ka si aktivitet primar të regjistruar mirëmbajtjen dhe servisimin e automjeteve, nuk do të thotë se i njejti ka nën pronësi objektin ku kryen këto servisime. Kërkesa teknike po ashtu lejon që të dorëzohet fleta poseduese e qiradhënësit, nëse një kontratë e qirasë ekziston, por në asnjë moment GOE fitues nuk ka dorëzuar një fletë poseduese e cila kërkohet shprehimisht me kërkesën teknike në fjalë.

Rrjedhimisht, vazhdon të qëndroj i vërtetë fakti i argumentuar nga GOE Segment Kosova se GOE fitues nuk ka dorëzuar ofertë të përgjegjshme në mungesë të fletës poseduese si kërkesë e detyrueshme nga dosja e tenderit.

Pika 1.3. Nuk është plotësuar kërkesa për kontrata për furnizime të ngjashme:
Kërkesa nr. 1 e Kërkesave për mundësitë teknike dhe/ose profesionale kërkon që "Operatori duhet të ofroj dëshmi të mjaftueshme se ka realizuar kontrata për furnizime të ngjajshme në tri vitet e shkuara nga data e publikimit të këtij Njoftimi per kontratë dhe atë në vlerë prej **jo me pak se 100,000.00"**, e cila dëshmohet me "Një listë të kontratave të realizuara duke plotësuar Aneksin 7- të dosjes së tenderit si dhe Listes ti bashkangjiten si deshmi (a)kur furnizimet janë bërë për një autoritet publik në Kosovë ose në një vend tjetër,për dëshmi të këtij furnizimi shërben kopja e certifikatës (certifikata ose raport pranimi ose referenca) të lëshuar ose të dhe te nenshkruar nga një autoriteti i tillë. **(b) kur furnizimet janë bërë për një blerës privat, përdëshmi të këtij furnizimi shërben kopja e çdo dokumenti të nënshkruar nga bleresi qe evidenton nje furnizimit të tillë.** Vërejtje Referenca ose raporti i pranimit te furnizimeve duhet të jenë në perputhje me listen e prezantuar."
GOE fitues në lidhje me këtë kërkesë ka dorëzuar listën e kontratave dhe faturave të blerësve privat. Në këtë drejtim, vetëm faturat dhe referencat n**ga Nil Holding LLC dhe nga N&B Sh.P.K. janë të nënshkruara nga pranuesi i mallit/blerësi**. Këto dy dëshmi së bashku përbëjnë vlerën prej **EUR 78,000.00.**
Duhet theksuar se kërkesa për këtë kërkesë ka qenë d**ëshmia e dokumenteve të nënshkruara nga blerësi që evidentojnë se GOE ka kryer një furnizim të ngjashëm me atë që kërkohet nga dosja e tenderit. Dokumentet e tjera nuk janë të nënshkruara nga blerësit, me ç'rast nuk mund të pranohen si dëshmi për furnizim të ngjashëm. Pra, GOE fitues nuk arrinë vlerën minimale të furnizimit prej 100,000 EUR pasi që nuk ka mundur të dëshmoj siç kërkohet nga dosja e tenderit përmes nënshkrimeve të blerësve për të arritur këtë vlerë.**
AK në përgjigje ndaj këtij pretendimi thote se GOE fitues kanë dorëzuar listën e kontratave duke prezantuar 7 kontrata të realizuara, si dhe ka bashkëngjitur referenca dhe fatura, të cilat deshmojnë se furnizimet janë kryer për bleres privat prandaj për AK ka

qenë e pranueshme.

AK përsëri a**nashkalon kërkesën teknike të kërkuar nga vet ajo që faturat që dëshmojnë kontratat duhet të jenë të nënshkruara** nga blerësit privat. Kjo kërkesë teknike është shumë e logjikshme, pasi që një OE mund të lëshoj fatura sa herë që ka dëshirë përmes sistemit, por përderisa nuk nënshkruhet nga blerësi, nuk ka asnjë lloj fuqie ligjore. Prandaj edhe faturat e dorëzuara nga GOE fitues nuk munden që objektivisht të konsiderohen si dëshmi për kontratat që ka dorëzuar, prandaj edhe nuk mund të konsiderohet se oferta e dorëzuar nga GOE fitues është e përgjegjshme.

Pika 1.4. Nuk është plotësuar kërkesa për Deklaratë Garancioni:

Aneksi 1 kërkon që "*Furnizuesi duhet të ofrojë **garanci tregtare** sipas prodhuesit për pjesët mekanike, elektrike dhe elektronike minimum 36 muaj".* GOE fitues nuk ka dorëzuar një deklaratë garancioni të kërkuar, dhe si i tillë nuk plotëson një kusht tjetër të specifikimeve teknike të detyrueshme.

Përgjigja e AK në këtë pikë ishte se në ofertën teknike të prodhuesit, pika nr.35 përshkruan garancionin prej 36 muajsh, dhe meqë oferta teknike është e nënshkruar nga prodhuesi, kjo ka qenë e pranueshme.

Kërkesa nga dosja e tenderit kërkon garancionin tregtar i cili duhet të lëshohet ndaras nga oferta teknike, prandaj vet fakti se oferta teknike përmban këtë informatë nuk do të thotë se kërkesa teknike plotësohet.

1. **2. Pretendimi Ankimor nr. 2: AK shkel parimet e ekzaminimit dhe vlerësimit të tenderëve dhe parimin e jodiskriminimit, të transparencës dhe barazisë -** Kërkesa nr. 4 për mundësitë teknike dhe/ose profesionale kërkon që "Operatori Ekonomik, me tenderin e tij, duhet të dorëzojë dokumentacion të skanuar, nga prodhuesi, përmes të cilit mund të verifikohen të dhënat teknike të Eskavatorit, të kërkuara në këtë tender tek Aneksi 1 Specifikacionet teknike", e cila dëshmohet me "**Katallogje, manuale apo broshura të Eskavatorit, të përgaditura nga prodhuesi".**

Në lidhje me këtë kërkesë, dokumenti i dorëzuar nga OE fitues është një deklaratë nga prodhuesi mbi specifikimet teknike të eskavatorit, mirëpo jo një katalog manual apo broshurë sikurse është kërkuar nga dosja e tenderit.

AK **pas hapjes së tenderëve** ka kërkuar nga GOE që të dorëzoj një katalog, e që GOE pas kërkesës së AK-së e dorezoi ate, pra ka dorezuar katalogun pas hapjes se tendereve. Kjo krejtësisht në kundërshtim me nenin 72 të LPP-së, nenin 40, paragrafin 4 të Rregullores së Prokurimit, si dhe Udhëzuesit për Prokurimin, pika 10.1.
AK vlerëson se oferta teknike e dorëzuar tregon në anën e majtë specifikacionet e AK a

ndersa ne anen e djathte oferten teknike te tyre prandaj për AK ka qenë e pranueshme oferta teknike dhe e njejta hynë në grupin e evidencave nr.4 te kerkuara: (manuale apo broshura të Eskavatorit, të përgaditura nga Prodhuesi). Ndërsa pas hapjes së tenderit ka kërkuar sqarime, duke kërkuar që të dorëohet edhe katalogu i prodhuesit. Meqë oferta dhe katalogu kanë qenë identike, GOE fitues është konsideruar se ka përmbushur këtë kërkesë.

Sipas nenit 72 i LPP-së, kur informacioni apo dokumentacioni që duhet të dorëzohet nga operatorët ekonomikë është ose duket të jetë jo i plotë ose i gabuar, ose kur mungojnë dokumentet specifike, AK mund të kërkojnë nga operatorët ekonomikë qe të dorëzojnë, plotësojnë, sqarojnë apo kompletojnë informacionin apo dokumentacionin e duhur brenda një afati te caktuar kohor, me kusht që kërkesat e tilla bëhen në përputhje të plotë me parimet e trajtimit të barabartë dhe transparencës. Kjo në asnjë aspekt nuk nënkupton që AK mund të kërkojë dokumentacione shtesë nga ato të dorëzuara në tender të cilët nuk janë referuar nga OE e as nuk kanë përbërë dëshmi përmes së cilës mund të përmbushet kërkesa në fjalë.

Paragrafi 3 i këtij neni specifikon se sigurimi i informacionit qe mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet **vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve**, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive.
Broshura e dorëzuar nga GOE fitues pas kërkesës së AK-së nuk përmban datë të lëshimit, prandaj kushti që vetëm dokumentet të cilat kanë ekzistuar para datës së skadimit për dorëzim të tenderëve nuk është plotësuar dhe ky dokument si i tillë nuk mund të verifikohet në mënyrë objektive në shkelje të nenit 72.3 të LPP-së.

Për më tepër, Neni 40, paragrafi 4, i Rregullores për Prokurim, i mundëson AK-së që t'i drejtohet OE-ve me kërkesa për sqarim por "**pa ndonjë ndryshim të kushteve materiale ose aspekte të tenderit"**.
Në këtë kontekst, Udhëzuesi i Prokurimit, në pikën 10.1 përcakton se kur "Mungon specifikacioni teknik për mallrat e ofruara dhe katalogu", **tenderi refuzohet pa kërkuar informacion të mëtejshëm**.

Kjo veprim i AK-së jo vetëm se shkel procedurat e ekzaminimit, por shkel edhe nenin 7 të LPP-së i cila ndalon çdo lloj diskriminimi ndaj OE-ve duke favorizuar një tjetër.

Prandaj, shpallja e GOE fitues pas kërkesës së AK për dokumentacion shtesë e cila nuk është dorëzuar me tender sipas dosjes së tenderit, është në kundërshtim me dispozitat ligjore për prokurim publik, ndërsa për shkak të kësaj mungese GOE fitues është dashur të eliminohej.

<u>KËRKESA:</u>

Mbi bazën e argumenteve të mësipërme, kerkojme nga Organi Shqyrtues i Prokurimit që

të nxjerr Vendim ashtu që:

I. **APROVOHET** në tërësi si e bazuar Ankesa e GOE Segment Kosova SH.P.K. & Segment SH.A ndaj aktivitetit te prokurimit me nr. të prokurimit KURM-25-262-1-2-1, me Titull: "Furnizim me Eksavator".

II. **ANULOHET** Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontaktues.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

GOE Segment Kosova shpk; Segment Sh.A është i detyruar të mbrojë interesat e tij ekonomike dhe ligjore. Rrjedhimisht, në rast të vazhdimit të veprimeve kundërligjore, OE në fjalë është i detyruar të veprojë me të gjitha mjetet ligjore në dispozicion.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,
f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe
g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*